

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NADAVKI  
Nr/Br. 199/20  
Datë/Datum. 23.03.20  
PRISHTINË - PRIŠTINA

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Nr i Prokurimit -00220-20-568-1-3-6

Nr i brendshëm 220-20-025-136

Sa i përket tenderit për Furnizim me klima për repartin e hemodializes në SP Mitrovicë"

**ANKESË**

**1. Identifikimi i ankuesit\***

"AS Tech"SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Tringe Smajli, Prishtine

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)(Kodi postar)

+383 44 770 161

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Afrim Sadiku

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpk.astech@gmail.com

(Adresa elektronike)

23.03.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

**2. Identifikimi i avokatit**

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate 27.02.2020

Data e dorëzimit të tenderit 03.03.2020

Njoftimi për anulim 12.03.2020

Data e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim 12.03.2020

Data e pergjigjes se kerkeses per rishqyrtim 13.03.2020

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

☒

Jo

☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

☒

Jo

☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

**43. Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve-RRUOPP**

**44. Ndërprerja e procedurave të prokurimit- 44.1 Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit - RRUOPP**

**Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**

**Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**

**43. Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve**

43.1 Të gjithë tenderuesit / kandidatët duhet të informohen nga AK, përmes publikimit të Formularit B58 - Njoftimit mbi Vendimin e AK, pa vonesë, në platformën elektronike si



dokument shtesë nëpërmjet funksionit Dosja e Tenderit - “shtoni dokument të ri”. 43.2 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme. 43.3 Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, AK do të përgatite dhe publikoj Njoftimin për Dhenie të kontratës në platformën e prokurimit elektronik. Data e publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK, respektivisht njoftimit të tenderuesve/kandidateve përbën: Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 95 Datën kur të gjitha informatat në lidhje me aktivitetin e prokurimit (përveç informatave sekrete të biznesit) janë në dispozicion për palet e interesit. Data e njoftimit të tenderuesve/kandidateve është “dita 0” e 5 ditëve të obligueshme të periudhës “në pritje”.

#### **44. Ndërprerja e procedurave të prokurimit**

**44.1 Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit**, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikoj Formularin B58 “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë. **44.2** Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatite Njoftimin për Anulim të aktivitetit të prokurimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik. **44.3** Dorëzimi i njoftimit të anulimit të tillë në KRPP dhe publikimi i njoftimit të tillë nuk është i nevojshëm për kontratat me vlerë minimale.

Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

**44.7** Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme: (i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve; (ii) nëse AK gjatë përgaditjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-së është i riparueshëm; (iii) është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-së dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i riparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP; (iv) nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasoje e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-së dhe AK. dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja.

#### **Neni 59**

#### **Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**

1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyrues lidhur me këtë çështje.



2. Autoriteti kontraktues mundetqë me shkrimtë kërkojënganjëtenderues që të sigurojnë një sqarim me shkrim mbi cilindongaaspektetenderittëtij,në mënyrëqëtë bëhetekzaminimi, vlerësimiose krahasimiitenderëve. Asnjëndryshim material dheasnjëaspekti tenderitnuk duhet të kërkoheose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga njëtenderues.

#### Neni62

#### PërfundimiiAktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

*\*\* Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë rrejtshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**1.AK SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**  
ka bërë anulimin e tenderit "Furnizim me klima për repartin e hemodializes në SP Mitrovicë" me datën 12.03.2020, duke dërguar Njoftim mbi anulim të aktivitetit.  
Kjo është shkelje e ligjit të prokurimit publik, neni 43 i rregullave të udhëzuesit, pasi qe njoftimi fillimisht duhet të bëhet me Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të pritët 5 ditë për pranim të Kërkesave për rishqyrtim.

Poashtu edhe arsyeja e anulimit është fare banale, pretendimi i AK se ka bërë gabim në paramasë në vend të klimave 1200 BTU duhet të jete 12000 BTU dhe në vend të 2400BTU duhet të jete 24000BTU është i palogjikshëm sepse është një gabim teknik i AK qe OE njohës të kësaj fushe e kanë ditur për çfarë klima bëhet fjale dhe nuk ka krijuar huti

aspak, për me tepër klima 1200 BTU dhe 2400BTU nuk ekziston prandaj nuk ka pasur paqartësi të OE sepse e kanë ditur se behet fjale për klima 12000 BTU dhe 24000BTU. Nëse kishin ekzistuar 1200 BTU dhe 2400BTU do të krijohet problem në implementim të kontratës por në këtë rast të gjithë OE kanë ofertuar dhe kanë dhënë çmim për klimat 12000BTU dhe 24000BTU.

**AK ka bërë shkelje të nenit 62 të Ligjit të prokurimit publik, arsyeja e anulimit të aktivitetit nuk arsyetohet me asnjë nga rastet e cekura në ligj.**

2.Oferta e OE me të lirë në hapje të tenderit është abnormalisht e ulët e llogaritur me rregulloren e ligjit të prokurimit publik për çmimet abnormalisht të ulëta.

Cmimi i dhënë nga ai nuk arsyetohet as blerjet në treg të këtyre paisjeve, prandaj oferta me të lirë e përgjegjshëm është e AS Tech SH.P.K.

Konsiderojmë se AK ka vepruar në mënyrë tendencioze në anulim të aktivitetit dhe nuk ka lënë hapësirë as për Kërkesë për rishqyrtim brenda 5 ditëve vetëm që të mos ju jepet hapësirë OE të përgjegjshëm për ankese.

AK na ka refuzuar Kërkesën tonë për rishqyrtim, duke e konsideruar të bazuar veten pretendimin se është dashur të dergoj Vendimi i AK dhe jo të anulohet procedura dhe jo edhe gabimet tjera, ku përgjegjësi mban zyrtari i prokurimit për gabime teknike gjatë vlerësimit të tenderit dhe shkelje të qëllimshme ku anulon aktivitetin vetëm pse OE i caktuar nuk është me të lirë i përgjegjshëm.

Ju lutem të aprovohet si e bazuar ankesa e AS Tech, lenda të kthehet në rivlerësim, dhe të rekomandohet OE AS Tech SH.P.K. për dënim të kontratës.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Te pa përcaktuara**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit."*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*